

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil me Gjykatësin **Drilon HARAÇIA**, me sekretaren juridike Valbone Hoxha, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses Kompania Kosovare për Distribuum dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A (KEDS) – Prishtinë, kundër të paditurit V. (N.) L. nga Gjakova, për kompensimin e dëmit material, vlera e kontestit 993,89 €, jashtë shqyrtimit **me dt.17.10.2017**, mori këtë:

A K T G J Y K I M PËR SHKAK TË PADEGJUESHMËRISË (MOSBINDJES)

MIRATOHET në tërësi kërkesë – padia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuum dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A (KEDS) – Prishtinë, ashtu që të **DETYROHET** e paditura V. (N.) L. nga Gjakova, që në emër të kompensimit të dëmit material t'ia paguaj paditëses shumën prej **993,89 € (nëntëqind e nëntëdhjetë e tre euro e tetëdhjetë e nëntë cent)**, me kamatë ligjore 8% duke filluar nga data 05.07.2017 (data e parashtrimit të padisë), gjerë në pagesën definitive, si dhe në emër shpenzimeve procedurale shumën prej **20,00 € (njëzet euro)**, e të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së Aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pala paditëse në padi pranë kësaj Gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit të lartcekur për kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 993.89 €, duke theksuar se i padituri deri me dt.20.09.2013, me qëllim që vetit ti sjell pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, ashtu që jashtë njëzorit elektrik përmes kabllor është lidhur direkt në rrjetin elektrik, me këto veprime energjia nuk është regjistruar saktë. Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr.411/14 të dt.22.09.2015 i cili ka marrë formën e prerë me dt.23.10.2015 i padituri është shpall fajtorë për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 KPK-së. Dhe si prova paditësja, padisë ia ka bashkangjitur; Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr.411/14 të dt.22.09.2015, i cili është i formës së prerë nga data 23.10.2015, Fatura me numër 817/2013 të dt.09.10.2013 dhe faturën DGJ13HP03250 të dt.09.10.2013, për rikthimin e humbjeve.

Gjykata në kuptim të nenit 394 të Ligjit për procedurën kontestimore nr.38/2008 i publikuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës” me dt.20.09.2008, i ka dërguar të paditurës padinë, provat materiale dhe Aktvendimin për dhënien e përgjegjës në padi.

Duke e bërë shikimin në flete dërgesën për dorëzim personal konstatohet se i padituri i lartpërmendur e ka pranuar Aktvendimin C.nr.358/17 të dt.04.08.2017, padinë dhe provat materiale, me dt.14.08.2017 (ku nga ana e zyrtarit postar është konstatuar se familja refuzon marrjen), mirëpo edhe pse ka kaluar afati i paraparë për dhënien e përgjegjës në padi, i njëjti nuk ka parashtruar përgjigjen në padi, andaj duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 150.1 të LPK të larte cituar Gjykata mori Aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë (mosbindjes) ndonëse janë plotësuar kushtet siç më poshtë vijojnë:

a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt padia, provat materiale dhe thirrja-aktvendimi për dhënien e përgjegjës në padi,

b) Themelësia e kërkesë-padisë rezulton nga faktet e treguara në padi, dhe

c) Faktet mbi të cilat mbështetet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi.

Andaj, në kuptim të nenit 160.6 të Ligjit për procedurën kontestimore janë dhënë vetëm arsyet e sipërcituara që e justifikojnë marrjen e këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar komfor nenit 452.1 të LPK, me ç ‘rast palës paditëse i janë pranuar shpenzimet në emër të taksave gjyqësore shumë prej 30,00 €.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.358/17, me dt.17.10.2017.

GJYKATËSI,
Drilon HARAÇIA

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.